

Prezantim – 1 qershor

Pershendetje te gjithëve une jam Saimir Haxhiu, mediator kulturor.

Jam ketu sot, para jush, per te sjelle jehonen e zerit te atij grupi femijesh qe une dhe koleget e mi i ndeshim shpesh ne rruge cdo dite por, qe nuk i shohim duke luajtur neper parqe, nuk i shohim as me canta ne supe duke shkuar ne shkolle dhe shpesh mund t'ju ndodhi te mos i shohin as “si femije”.

Do te flasim pikerisht per dëshirat e atyre qe fshijne xhamat e makinave apo zgjatin doren per te lypur ndonje qindarke.

Ne qendren ku une dhe koleget e mi punojme organizohen shpesh grupe diskutimi me keta femije qe e kalojne ditën ne rruge bile shpesh edhe naten mbi endrrat dhe dëshirat qe ata kane. . . por jo gjithmone ata mund te shprehin apo shkruajne dhe mendojne.

Gjate bisedave te perditshme me ta, pyetjes se zakonshme se: Cfare do te behesh kur te rritesh?

Ata shpesh i pergjigjen “*asgje*”. Ndonjehere duket sikur ata nuk kane pasur asnjehere femijeri.

- Une si gjithe femijet e tjere kam dëshire te kem lodra, kukulla, top, kompjuter e shume gjera te tjera.

Por . . . ndryshe nga femijet e tjere mua me mungon nje tavoline me nje pjate me ushqim te ngrohte dhe pse jo do te doja edhe nje gote me koka- kola, nje krevat qe te shtrij kembet se rri gjithe ditën ne trotuar dhe ne dysheme , televizor qe te shoh borebardhen dhe spaidermenin.

Nuk dua qe kur jam ne rruge ca teta dhe ca xhaxha te me shajne dhe te me thone “lypsar” se une jam edhe femije.

Nuk dua te shkoj larg me bidona te mbush uje, dua uje te shtepia dhe shampo per tu lare dhe lavatrice qe te mos i laj rrobat me dore.

Dua te ngrihem ne mengjes dhe te shkoj ne shkolle, jo te dal te qendra e Tiranes te lyp dhe punoj

Nuk me vjen mire kur shoket dhe shoqet e klases, nuk me flasin se jam pis dhe nuk di te sillem ne klase..

Keto jane disa nga dëshirat te cilat femijet ne qendren tone i shprehin cdo dite me goje, me vizatime, me sy te mbushura me lot dhe me buzeqeshjen e tyre.

Faleminderit te gjithëve!